



**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 84/2021 (JR)
Nr. 84/2 regj.

Tiranë, më 16 .9 .2024

SHPALLJE

E

NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se **ditën e martë, në datën 22.10.2024, ora 10:00**, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit me nr. regjistri 84/2021, datë 29.12.2021, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Ermir Lelçi kundër vendimit nr. 465, datë 28.10.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca gjyqësore në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë.

Trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese e trupit gjykues
Relatore e çështjes
Gjyqtare
Gjyqtare
Gjyqtare

Natasha Mulaj
Albana Shtylla
Ina Rama
Mimoza Tasi
Rezarta Schuetz

Bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri në 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES

GJYQTARE


Natasha MULAJ
